



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1228 Prot.

Tiranë, më 03.10 2018

VENDIM Nr. 190, datë 25.09.2018

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8, datë 25.09.2018, pasi shqyrtoi Konceptin e sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit *"Strukturë banimi dhe shërbimesh 3 - 6 kate dhe 1 kate nën tokë"*, rruga *"Hysen Kërtusha"*, zonë arkeologjike *"B" Durrës*- subjekti "PAVARËSIA" sh.a., paraqitur nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama,

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin me tre sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit *"Strukturë banimi dhe shërbimesh 3 - 6 kate dhe 1 kate nën tokë"*, rruga *"Hysen Kërtusha"*, zonë arkeologjike *"B" Durrës*- subjekti "PAVARËSIA" sh.a., paraqitur nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.
2. Subjekti "PAVARËSIA" sh.a. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizojë sondazhet arkeologjike, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr.384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

4. Investitori "PAVARËSIA" sh.a. si dhe subjekti i licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhet arkeologjike, në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Rregullores "Mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut" (i ndryshuar) dhe akt-marrëveshjes tre palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazheve, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me to.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO